



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KLOS
NJËSIA E PROKURIMIT

Klos, më 04.03.2024

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR PROCEDURËN E PROKURIMIT “E HAPUR – MALLRA”

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Karburanti (Naftë+Benzinë) - (Diesel 10 ppm ULSD)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **09134200-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 083 333 (*Njëzet e pesë milion e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Klos ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1/1;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Jane parashikuar ne kriteret e pergjithshme.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

2.2.2 Kopje të certifikuara të bilanceve të 3 (*tre*) viteve të fundit (**2020, 2021, 2022**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga nenin 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqerohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (*dy*) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2 Germa b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

25 083 333 (*Njëzet e pesë milion e tetëdhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre*) lekë pa t.v.sh.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 43 pika 2 germa b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 në zbatim të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB). *Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit.*

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates furnizime të mëparshme, të ngjashme me objektin e këtij prokurimi me vlerë totale jo më të vogël se 40% e fondit limit:

a) Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik të shoqëruara me fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes te plotësuara sipas legjislacionit ne fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 pikë të tregëtimit të karburantit brenda territorit të Bashkisë Klos (Njesia Administrative Klos), e pasqyruar kjo tek të dhënat në Ekstraktin e QKB-së dhe e pasqyruar me Adresë Sekondare, shoqëruar me Certifikate Pronësie ose Kontratë Qiraje ose Kontrate Bashkepunimi ose Kontratë Shërbimi.

a- Per te provuar kriterin e mesiperm OE duhet te paraqese Çertifikata/Vertetim Pronesie ose kontrate qiraje ose kontrate bashkepunimi si dhe dokumentacionin e kerkuar ne piken c.

b- Per te vertetuar kriterin e distances, KVO-ja, do ti referohet ekstraktit te QKB te subjektit (vendndodhjes se ushtrimit te aktivitetit), nepermjet adreses elektronike te QKB-se.

c- Stacioni i mesiperm i tregtimit te karburantit detyrimisht duhen te jete i pajisur me:

- Leje mjedisore leshuar nga QKL, sipas legjislacionit ne fuqi.

- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Nisur nga fakti qe objekti i kontrates ka te beje me furnizimin me karburant te mjeteve te Bashkise Klos rrjedhimisht edhe pika e furnizimit duhet te jete brenda territorit te Bashkise Klos, pasi ne nje distance me te larget do te sillte kosto shtese per institucionit.

2.3.3 Autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) e lëshuar nga Njësia Vendore dhe që plotëson kushtet e legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë, për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. VKM Nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ndryshuar me Vendim Nr. 344, datë 19.4.2017.

2.3.4 Fletë analiza të lëshuar nga ISHTI të vlefshme.

Argumentimi: Në bazë të pikës 6, nenit 40, germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë, , kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Si dhe VKM Nr.147, datë 21.3.2007 PËR CILËSINË E LËNDËVE DJEGËSE, BENZINË DHE DIEZEL

Me ane të këtij kriteri Autoriteti kontraktor vërteton që malli objekt prokurimi është sipas specifikimeve teknike të kerkuara.

2.3.5 Deklaratë e administratorit të ofertuesit që garanton dhe është i disponueshëm për furnizimin 24/24 për 7 ditë javës.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kjo pike e vendosur nga AK i shërben Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik të jete i disponueshem ne cdo dite/ore per furnizimin me karburant te mjeteve.

2.3.6 Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasise se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasise se karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me ane të emailit për cdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit të shitjes se karburanteve me pakice me qëllim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj.

Argumentimi: Bazuar ne VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem”, sipas të cilit Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepemjet kartes elektronike (Deklarate nga subjekti ofetues).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar jo me pak se tre persona ne periudhen Dhjetor 2023 e ne vazhdim per kete duhet te plotesoje formularin permbledhes te vetedeklarimit duhet te dorezoje Listpagesen per periudhen e kerkuar (e –SIG 25).

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqese:

- *Një vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar te punonjësve për periudhën Dhjetor 2023 e në vazhdim.*
- *Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Dhjetor 2021 e në vazhdim.*

“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5 germa c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë te dëshmojnë fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

SPECIFIKIME TEKNIKE

- Karburanti (Naftë “GAZOIL D1”) objekt prokurimi duhet të jetë.

Të dhënat teknike të Gazoil D1 (Eurodizel) i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH); Specifikimet teknike të mallit objekt prokurimi janë sipas standartit në fuqi për **Gazoli D1 (Diezel) 10 PPM S SH EN 590:2022 ose ekuivalente me të.**

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Gazoil S SH EN 590:2022

Treguesi cilësor	Njësia e matjes	Normat e lejuara		Metoda e provës
		minimale	maksimale	
Numri i cetanit ^b		51,0	-	S SH EN ISO 5165
Indeksi i cetanit		46,0	-	S SH EN ISO 4264
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	820	845	S SH EN ISO 3675 S SH EN ISO 12185
Hidrokarburët aromatikë policiklikë ^{d, e}	% (m/m)	-	8,0	S SH EN ISO 12916
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg	-	10,0	EN ISO 20846
Pika e flakërimit	°C	mbi 55	-	S SH EN ISO 2719
Graviteti API	llogaritje	-	-	ASTM D 4052
Përmbajtja e hirit	% (m/m)	-	0,01	S SH EN ISO 6245
Pika e bllokimit të filtrit CFPP	°C	-		S SH EN 116
Korrozioni në shufër bakri (3 orë në 50 °C)	vlerësim	klasa 1		S SH EN ISO 2160
Përmbajtja e esterit metilik të acidit yndyror (FAME)	% v/v	-	7	S SH EN ISO 14078
Viskoziteti në 40 °C	mm ² /s	2,00	4,50	S SH EN ISO 3104
Përmbajtja e ujit	% (m/m)	-	0.020	S SH EN ISO 12937
Vetitë lubrifikuese, diametri i korrektuar i njollës së gripuar (gërryer) (ë sd 1,4) në 60 °C	µm	-	460	S SH EN 12156-1
Pika e turbullimit	°C	-	-	S SH EN ISO 23015
Distilimi ^{h, i} distilati që vlon ÷ në 250°C,%(v/v)	% (V/V)		< 65	S SH EN ISO 3405
distilati që vlon ÷ në 350 °C,%(v/v)	% (V/V)	85		
distilati që vlon në 95 % (v/v)	°C		360	

➤ Karburanti “Benzinë pa Plumb” objekt prokurimi duhet të jetë.

Të dhënat teknike të Benzinë pa plumb i referohen standardit evropian (EN) të adoptuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit dhe që ka statusin e standardit shqiptar (S SH):
Specifikimet teknike sipas **S SH EN 228:2012 + A1:2017**.

Kërkesa të përgjithshme të zbatueshme dhe metodat e provave

Benzinë S SH EN 228:2012 + A1:2017

Treguesi cilësor	Njësia e	Normat e lejuara	Metoda e provës ^a
------------------	----------	------------------	------------------------------

	matjes	minimale	maksimale	(Shiko paragrafin Rekomandimet e detyrueshme)
Numri i oktanit kërkimor, RON*		95	-	S SH EN ISO 5164 ASTM D 2699-15
Numri oktanit motorrik, MON*		85	-	S SH EN ISO 5163 ASTM D 2699-15
Densiteti në 15 °C ^c	kg/m ³	720	775	S SH EN ISO 12185 S SH EN 3675 ASTM D 7777 ASTM D 4052
Përmbajtja e squfurit ^f	mg/kg		10,0	SH EN ISO 20846
Korozioni i shufrës së bakrit (3 orë në 50 °C)	Renditje	klasa 1		S SH EN ISO 2160
Graviteti API*	Analitike			ASTM D 4052
Distilimi*				
Distilon deri 70 °C	% (v/v)	20	48	S SH EN ISO 3405 ASTM D 86
Distilon deri 100 °C	% (v/v)	46,0	71,0	
Distilon deri 150 °C	% (v/v)	75		
Pika finale e distilimit	°C	-	210	
Mbetjet e distilimit	% (v/v)	-	2	
Përmbajtja e tipit të hidrokarburit				
Olefinat*	% (v/v)		18,0	S SH EN 238:1996/A1:2003 ASTM D 6277-07 (2012)
Aromatikët*	% (v/v)	-	35,0	
Përmbajtja e benzenit	% (v/v)	-	1,0	
Përmbajtja e oksigjenit*	% (m/m)	-	2,7	
Përmbajtja e komponimeve oksigjenore*				
Methanol (alkool metilik)*	% (v/v)	-	3	S SH EN ISO 15553 :2007 ASTM D 5845-01 (2011)
Etanol (alkool etilik)*	% (v/v)	-	5	
- Alkool izopropilik - Alkool izo butilik - Alkool tere butil - Etere (me 5 ose më shumë atome C) - Komponime oksigjenore të tjera		}	Përzierja në vëllim i kufizuar në 2.7% (m/m) të përmbajtjes maksimale të oksigjenit	

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Lejen e Tregtimit të Karburanteve në përputhje me Ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 *“Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”* (me ndryshimet përkatëse), të shoqëruar me Autorizimin për Lejen e Tregtimit të Karburanteve, në zbatim të Ligjit Nr. 8450 datë 24.02.1999 *“Për*

përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre” (me ndryshimet përkatëse).

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë dhe garantojë furnizimin me karburant sipas standardeve shtetërore në fuqi **S SH EN 590:2022** (Diesel) dhe **S SH EN 228:2012 + A1:2017** (Benzinë pa plumb) **ose ekuivalente me to, të njohur nga Standartet Shqipëtare**, me lëng, karta elektronike të vlefshëm në pikat e shitjes së karburantit.

- **Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fletë - analizë lëshuar nga organi kompetent që vërteton cilësinë e secilit produkt objekt i kësaj kontrate që Operatori Ekonomik tregëton, sipas standarteve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike të marrë jo më parë se muaji Shtator 2023.**
- **Afatet e lëvrimit: Malli do të ofrohet për gjatë gjithë periudhës me karta elektronike, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë furnizim sa herë ta ketë të nevojshme. Kërkesa do jetë në formën e kërkesës zyrtare me shkrim ose në mënyrë elektronike (e-mail).**

Operatori ekonomik duhet të sigurojë furnizimin në stacion të shitjes së karburantit me pakicë në pistoletë publike me shërbim 24 orë në çdo ditë të javës, deri në përfundim të Kontratës dhe me vendndodhje në Njësinë Administrative Klos/ Bashkia Klos me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të autoritetit kontraktor, në adresën e kërkuar dhe sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një ndërfaqe menaxhimi të karburanteve (ë ebpge), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nëpërmjet kartës elektronike. Kjo ndërfaqe e menaxhimit të karburanteve (ë ebpge) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, dhe nga llogaria elektronike e AK në mjetet e transportit, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vet Autoriteti kontraktor. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit të disa raporteve të cilat do të ndihmojnë AK për marrjen e vendimeve operacionale.

Sasia e karburantit do të jetë e disponueshme për t’u tërhequr nëpërmjet tollonave ose e kredituar në kartat elektronike të personalizuar me targën e mjetit, në pikën e karburantit të shoqërisë. Furnizimi të kryhet sipas nevojave, në llogarinë elektronike të AK, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë një aplikacion elektronik për kreditimin në kohë reale të sasisë së karburantit me mënyrën elektronike për çdo mjet të AK. Kartat elektronike të furnizimit duhet të ofrohen nga Operatori Ekonomik për Autoritetin Kontraktor pa kosto shtesë sa herë që të jetë e nevojshme. Kërkesat për pajisje me kartë elektronike furnizimi do të bëhen nga përfaqësuesi i AK me shkresë zyrtare ose e-mail.

- Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të jenë të përdorshme gjatë viteve 2024-2025.

Furnizimi i mjeteve të A.K., do të bëhet çdo ditë 24h/24h .

E drejta për të kërkuar fillimin e lëvrimit të karburantit do të jetë menjëherë nga momenti i nënshkrimit së kontratës, por gjithmonë sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Malli do të ofrohet duke kredituar llogarinë elektronike të AK sipas nevojave. OE duhet të furnizojë me karburant AK, lëvrimi i mallit do kryhet periodikisht duke kredituar llogarinë elektronike.

Me paraqitjen e kërkesës nga AK kontraktuesi është i detyruar të furnizojë autoritetin kontraktor në sasinë korresponduese të sasisë elektronike duke përfshirë në çmimin e tyre gjithë detyrimet fiskale që ka shteti shqiptar.

Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër: 2 (dy) vite

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
2. _____
3. _____